

Instituti "Octopus":
Të ndëshkohet Serbia për
agresionin e 24 shtatorit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KQZ-ja PRANON PETICIONET PËR SHKARKIMIN E KRYETARËVE NË VERI, PRITET VERIFIKIMI I TYRE



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar të enjten peticionet e nënshkruara nga qytetarët për shkarkimin e kryetarëve të katër komunave në

veri të vendit. Kështu ka konfirmuar kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, në mbledhjen e këtij institucioni. "I kemi pranuar peticionet prej katër komunave

dhe verifikimi i nënshkrimeve do të bëhet në vijim. Ka numër të madh nënshkrimesh dhe nevojitet kohë për konfirmim", ka thënë Radoniqi

OSMANI ME HOMOLOGUN MAQEDONAS: TË DY SHTETET KANË VIZION TË PËRBASHKËT PËR NJË BALLKAN PERËNDIMOR STABIL



BE-ja: ZGJIDHJA E PROBLEMEVE
ME FOINJËT PËRMES DIALOGUT,
THELBËSORE PËR ZGJERIMIN

OPINION

VËSHITRË TË MBAHEN
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME
NË VITIN 2024

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



VUÇIQI: KOSOVA PO ARMATOSET NË
MËNYRË TË PALIGJSHME

LARGOHEM BILLBORDET ILEGALE ME
SIMBOLE DHE IMAZHE TË DIKTATORËVE
E AGRESORËVE SERBË NË ZVEÇAN

EKONOMI



MINISTRI I BUJOËSISË SË
BULLGARISË VJEN NË KOSOVË
PËR VIZITË DYDITORE

DEMOKRACI PLUS THOTË
SE "TERMOKOS"-I BËRI DISA
SHKELJE NË TENDERIN ME VLERË
2.4 MILIONË EURO

SPORT



PËRFUNDON ME SUKSES SEMINARI
ME GJYQTARËT E SUPERLIGËS DHE
LIGËS SË PARË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vuçiqi: Kosova po armatoset në mënyrë të paligjshme

BEOGRAD, 25 JANAR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, akuzoi fuqitë perëndimore për armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe opozitën e mediet pro opozitës në Serbi se janë në shërbim të këtyre fuqive. Gjatë një aktiviteti në Beograd ai tha se është duke menduar se “si të fillojnë hetime për armatosjen e të ashtuquajturës Forca e Sigurisë së Kosovës dhe atyre që po ndihmojnë në këtë armatosje në kundërshtim me Rezolutën 1244. Dua të hetoj se kush e shkeli Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe si guxuan ta bëjnë atë ... Po mendoj si të mos e sjell vendin në pozitë të vështirë



dhe njëkohësisht të ruhet e drejta ndërkombëtare”, tha ai, raportoi Voa. Më herët gjatë këtij muaji Departamenti Amerikan i Shtetit

miratoi shitjen e mundshme të raketave “Javelin” për Kosovën me vlerë prej 75 milionë dollarësh. “Kjo shitje e propozuar do t’i mbështeste synimet e

politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara duke përmirësuar sigurinë e një partneri evropian, i cili është një forcë e rëndësishme për qëndrueshmërinë politike dhe ekonomike në Evropë”, tha Departamenti i Shtetit, sipas të cilit, shitja nuk do ta ndryshojë ekuilibrin ushtarak në rajon. Presidenti serb i cili e kishte cilësuar njoftimin “një zhgënjim të madh për Serbinë”, sulmoi mediet pro opozitare dhe opozitën në Serbi se “nuk duan t’ia dinë çfarë po i bëjnë të huajt dhe shqiptarët Serbisë”. “Juve ju intereson se si ta ndëshkoni

Serbinë, sepse disa serbë deshën t’i mbronin vatrat e tyre”, tha presidenti serb i pyetur nga gazetarët për ngjarjet në fshatin Banjskë në veri të Kosovës më 24 shtator të vitit të kaluar, kur një grup serbësh të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës duke vrarë një oficer dhe plagosur dy të tjerë. Kosova e ka akuzuar Beogradin për organizmin dhe armatosjen e grupit, por Beogradi mohon të jetë përfshirë në të. Përgjegjësinë për sulmin e mori përsipër Milan Radoiçiqi, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve të Kosovës, e cila është themeluar dhe mbështetur nga Beogradi.

Kovaçevski jep dorëheqje nga pozita e kryeministrit të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 25 JANAR - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovaçevski, të enjten, më 25 janar, ka paraqitur në Kuvend dorëheqjen e tij dhe të kabinetit qeveritar, me të cilin ka udhëhequr nga 11 janari i vitit 2022. Dorëheqja e Kovaçevskit bazohet në Ligjin për Zgjedhje dhe punën e qeverisë, me qëllim formimin e qeverisë teknike, e cila do të funksionojë 100 ditë, apo deri në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen

më 8 maj. Gjatë dorëzimit të dorëheqjes në Kuvend, Kovaçevski ka thënë se ai sërish do të kthehet në këtë post pas zgjedhjeve parlamentare. “Më 9 maj qeveria sërish do të udhëhiqet nga unë sikur edhe shumica parlamentare, e cila do ta sigurojë anëtarësimin e plotë të Maqedonisë së Veriut në BE deri në vitin 2030”, ka deklaruar Kovaçevski, i cili është edhe kryetar i Lidhjes Social Demokrate (LSDM). Ai ka thënë se zgjedhjet e 8 majit do të jenë

“betejë mes partive politike që favorizojnë orientimin perëndimor të shtetit dhe partive politike që janë për një orientim të qartë lindor të vendit”. Qeveria teknike, e cila pritet të votohet më 28 janar, do të udhëhiqet nga Talat Xhaferi, që vjen nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), i cili gjatë ditës së hënë jep dorëheqje nga pozita e kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.



Zelensky kërkon hetim ndërkombëtar pas akuzave të Kremlinit për rrëzimin e avionit



KIEV, 25 JANAR - Kremlini ka akuzuar sërish Ukrainën për rrëzimin e një avioni ushtarak rus, që tha se po bartte 65 ushtarë ukrainas të kapur gjatë luftës. Ata më 24 janar po transportoheshin me avion për këmbim të burgosurish. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky bëri thirrje për një hetim ndërkombëtar të këtij rasti. Avioni u rrëzua në rajonin e Belgorodit pranë kufirit me Ukrainën.

Rrëzimin e aeroplanit transportues ushtarak, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, e quajti “akt monstruoz”, megjithëse Moskë ende nuk ka treguar ndonjë provë se ai u rrëzua nga një raketë ukrainase apo që ushtarët ukrainas ishin në bord. Derisa nuk tha se kush e rrëzoi avionin, Zelensky tha se “duhet të vërtetohen të gjitha faktet... shteti ynë do të insistojë për një hetim ndërkombëtar”. Zyrtarët ukrainas kanë thënë se këmbimi i të burgosurve ishte

planifikuar të bëhej më 24 janar dhe Rusia nuk e kishte informuar Ukrainën se të burgosurit ukrainas do të fluturonin me aeroplanë mallrash. Drejtoria kryesore e inteligjencës e Ukrainës tha se nuk ka “informacion të besueshëm dhe gjithëpërfshirës” se kush ishte në bordin e avionit, por tha se të burgosurit rusë, për të cilët ishte përgjegjëse, “u dorëzuan në kohë në pikën e këmbimit të kushtëzuar ku ata ishin të sigurt”.

Koreja e Veriut thotë se ka testuar një raketë të re lundruese

PHENIAN, 25 JANAR - Koreja e Veriut tha të enjten se ka testuar fluturimin e parë të një rakete të re lundrimi, ndërsa zgjeron aftësitë e saj ushtarake përballë thellimit të tensioneve me Shtetet e Bashkuara dhe fqinjët. Raporti në medien

shtetërore erdhi një ditë pasi ushtria e Koresë së Jugut tha se zbuloi Veriun duke gjuajtur disa raketa lundrimi në ujërat e bregdetit perëndimor. Nuk u dhanë më shumë detaje lidhur me numrin e raketave të lëshuara ose karakteristikat e tyre të

fluturimit. Media shtetërore e Koresë së Veriut tha se raketa “Pulhwasal-3-31” është ende në fazën e saj të zhvillimit dhe se lëshimi nuk përbën kërcënim për fqinjët. Koreja e Veriut përshkroi raketën si “strategjike”.



Instituti "Octopus": Të ndëshkohet Serbia për agresionin e 24 shtatorit

PRISHTINE, 25 JANAR - Instituti për Studime të Luftës Hibride "Octopus" ka përmendur sërish sulmin e 24 shtatorit 2023 në Banjskë, ku mbeti i vrarë rreshteri policor Afrim Bunjaku. "Octopus" ka ritheksuar se është e rëndësishme që terroristët e përfshirë në këtë sulm të sillen para drejtësisë në Kosovë. "Dje u bënë katër muaj nga agresioni i Serbisë kundër Kosovës përmes sulmit paramilitar dhe terrorist në Banjskë - agresion ky i organizuar nga nivelet më të larta politike dhe ushtarake në Beograd.

Instituti 'Octopus' risjell në vëmendjen e publikut vendor dhe ndërkombëtar se Serbia dhe regjimi i Aleksandar Vuçiqit vazhdojnë t'u ofrojnë mbrojtje shtetërore terroristit Milan Radojçiq dhe grupit të tij paramilitar. Instituti 'Octopus', po ashtu, thekson nevojën që bashkësia ndërkombëtare ta shtojë presionin ndaj Serbisë, duke kërkuar përgjegjësi për organizimin e sulmit ndaj Kosovës më 24 shtator 2023. Prokuroria dhe institucionet e tjera relevante të Kosovës duhet të jenë të vetëdijshme për ndjeshmërinë e rastit

duke mos hezituar në hetimin e mëtejshëm dhe ngritjen e aktakuzave ndaj Milan Radojçiqit dhe të tjerëve të përfshirë në sulm. Është vendimtare që terroristët e përfshirë në sulmin në Banjskë të ekstradohen në Kosovë dhe t'i dorëzohen drejtësisë së Kosovës, njëkohësisht Serbia të ndëshkohet me sanksione ekonomike dhe politike për cenimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës", është thënë në reagimin e këtij instituti.



Osmani me homologun maqedonas: Të dy shtetet kanë vizion të përbashkët për një Ballkan Perëndimor stabil

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në vizitë pune presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski. Të dy liderët pohuan se ekziston potenciali për thellimin e bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit tregtar, kulturor, të shëndetësisë, arsimit, bujqësisë, turizmit, teknologjisë informative dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët

Mal QORRAJ
PRISHTINE, 25 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në vizitë pune presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski. Në takim me homologun e saj, presidentja Osmani rikonfirmoi përkushtimin për vazhdimin e marrëdhënieve të shkëlqyeshme me Maqedoninë e Veriut. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, sipas presidentes Osmani, janë urë lidhëse ndërmjet dy shteteve dhe shtyllë e stabilitetit, por edhe e procesit të integrimit evropian të Maqedonisë së Veriut. Osmani ka falënderuar presidentin Pendarovski për përkushtimin e tij personal për raportet e shkëlqyeshme ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Sipas presidentes Osmani, të dy

shtetet kanë vizion të përbashkët për një Ballkan Perëndimor stabil dhe të integruar në BE. Më tej, Osmani shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin nga Maqedonia e Veriut, duke theksuar rëndësinë e përpjekjeve të përbashkëta për stabilitetin rajonal. Presidentja Osmani tha se me mbështetjen e shteteve mike sikurse Maqedonia e Veriut, Kosova mund të avancojë në rrugën e integrimit evropian. Në këtë kontekst, Osmani tha se anëtarësimi në Këshillin e Evropës është në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim. Sipas presidentes Osmani, Kosova ka dëshmuar angazhim serioz në procesin e reformave rrënjësore, ndaj meriton ta marrë statusin e vendit kandidat në BE. Presidentja Osmani ka theksuar se Maqedonia e Veriut nuk është vetëm fqinje e Kosovës, por edhe



partnere në shumë procese. "Procesi i integrimit evropian është prioritet që na bashkon dhe në këtë rrugë ne do të vazhdojmë ta ndihmojmë njëra-tjetrën", ka theksuar presidentja. Në këtë kontekst, sipas

presidentes Osmani, përfshirja e Kosovës në PIF, më pas në NATO, ka një rëndësi strategjike dhe është garanci për stabilitet jo vetëm të Kosovës, por edhe të rajonit. Të dy liderët pohuan se ekziston

potenciali për thellimin e bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit tregtar, kulturor, të shëndetësisë, arsimit, bujqësisë, turizmit, teknologjisë informative dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.


Britania ka qenë dhe është aleate e Kosovës

PRISHTINE, 25 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur përfaqësuesit e Mbretërisë së Bashkuar në NATO, si dhe ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, i cili për disa vjet me punën e tij të shkëlqyer i shërbeu rritjes së bashkëpunimit të Republikës së Kosovës me Mbretërinë e Bashkuar në fushën e mbrojtjes dhe

sigurisë. Në takimin lamtumirës me ambasadorin Abbott, ministri Maqedonci e falënderoi atë për mbështetjen e vazhdueshme dhe shumë të rëndësishme që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës për ngritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, veçanërisht për kontributin për heqjen e vizave për

personelin civil dhe ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri theksoi faktin se shteti britanik ka qenë dhe është aleat i Kosovës në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e vendit tonë, si dhe ruajtjen e vlerave demokratike dhe se ambasadori Abbott do të mbetet mik i përjetshëm i Republikës së Kosovës.





KQZ-ja pranon petitionet për shkarkimin e kryetarëve në veri, pritet verifikimi i tyre

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar të enjten petitionet e nënshkuara nga qytetarët për shkarkimin e kryetarëve të katër komunave në veri të vendit. Kështu ka konfirmuar kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, në mbledhjen e këtij institucioni. “I kemi pranuar petitionet prej katër komunave dhe verifikimi i nënshkrimeve do të bëhet në vijim. Ka numër të madh nënshkrimesh dhe nevojitet kohë për konfirmim”, ka thënë Radoniqi

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka bërë me dije të enjten se kanë pranuar petitionet për shkarkimin e kryetarëve të katër komunave në veri, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Sipas tij, tashme pritet verifikimi i tyre. “I kemi pranuar petitionet prej katër komunave dhe verifikimi i nënshkrimeve do të bëhet në vijim. Ka numër të madh nënshkrimesh dhe nevojitet kohë për konfirmim”, ka thënë Radoniqi. Edhe zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se në përputhje me legjislacionin në fuqi, KQZ-ja do t'i verifikojë listat e nënshkrimeve. “KQZ-ja në përputhje me legjislacionin në

fuqi do ta verifikojë listën e nënshkrimeve, pra nëse nënshkruesit janë qytetarë me të drejtë vote në komunën përkatëse”, ka thënë Elezi. Në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konfirmon rezultatin e petitionit, kjo do t'i hapë rrugë shkarkimit të kryetarëve shqiptarë në komunat në veri që u zgjodhën në prill të vitit 2023, pasi zgjedhjet u bojkotuan nga serbët në shenjë pakënaqësie me politikën e Qeverisë së Kosovës. Në mënyrë që peticioni të jetë i suksesshëm, kërkohet të mblidhen të paktën 20 për qind të nënshkrimeve nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Sipas KQZ-së, në Mitrovicën e Veriut duhet të mblidhen së paku 3 640 nënshkrime për shkarkimin e kryetarit të

komunës, pasi në listën zgjedhore janë regjistruar 18 199 persona me të drejtë vote. Në komunën e Leposaviqit të drejtë vote kanë 13 441 persona, që do të thotë se të paktën 2 689 prej tyre duhet ta nënshkruajnë peticionin për shkarkimin e kryetarit. Në Zubin Potok peticionit duhet t'i përgjigjen së paku 1 347 votues, që është 20 për qind nga 6 732 të votuesve të regjistruar. E në Zveçan, që peticioni të jetë i suksesshëm, duhet të nënshkruhet nga së paku 1 411 persona. Në vendet ku janë grumbulluar nënshkrimet e qytetarëve ishin të pranishëm përfaqësuesit e Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit. Lista Serbe kishte iniciuar largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022 dhe më pas kishte bërë thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të prillit të vitit të kaluar. Largimi nga institucionet u bë në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me ndërrimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia në ato që lëshohen nga Kosova, por që atëherë kjo çështje është zgjidhur. Mirëpo, në mesin e tetorit të vitit 2023, kjo parti

deklaroi se ishte e gatshme të merrte pjesë në zgjedhjet në komunat në veri, pa vendosur asnjë kusht për pjesëmarrje në zgjedhje, siç kishte bërë më herët. Ky qëndrim i kësaj partie u mor pasi presidenti serb Aleksandar Vuçiq u bëri thirrje përfaqësuesve serbë në veri të Kosovës ta inicionin mbajtjen e zgjedhjeve të reja në mënyrë që “levat kryesore të pushtetit të jenë në duart e tyre”. Kësaj thirrjeje i parapriu një sulm i armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, kur një grup serbësh sulmuan Policinë e Kosovës duke vrarë një polic. Përgjegjësinë për sulmin e mori ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq.

Baza ligjore për largimin e kryetarëve të komunave

Sipas Udhëzimit Administrativ për shkarkimin e udhëheqësve të komunës, një grup qytetarësh, pas marrjes së autorizimit për të shfrytëzuar një zonë publike apo vend për të nisur një peticion, kanë 30 ditë kohë për t'i mbledhur nënshkrimet për shkarkimin e kryetarit. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë deri në 15 ditë. Mirëpo ministri i Administrimit

të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, deklaroi javën e kaluar se qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut kanë afat për t'i mbledhur nënshkrimet deri më 22 janar. Ai shtoi se afati për qytetarët e komunës së Zveçanit është më i gjatë për rreth pesë ditë për shkak se në KQZ është dorëzuar më vonë kërkesa për ta ditur numrin e saktë të votuesve të regjistruar. Nëse KQZ-ja konfirmon se nënshkrimet e mbledhura janë aq sa kërkohet dhe i verifikon ato, më pas organizohet votimi për shkarkimin e kryetarit, i cili duhet të mbahet brenda 45 ditësh. Që ky votim të jetë i suksesshëm, duhen 50 për qind, plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor 30 deri në 45 ditë për ta shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Nisja e detyrës së kryetarëve shqiptarë në komunat në veri nxiti tensione në fund të majit të kaluar, që kulmuan në Zveçan, pasi protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar uljen e tensioneve dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri të Kosovës.

BE-ja: Zgjidhja e problemeve me fqinjët përmes dialogut, thelbësore për zgjerimin

Ndarja e procesit të integritimeve evropiane nga dialogu me Serbinë, në Bruksel konsiderohet e palogjikshme dhe e pamundur

PRISHTINË, 25 JANAR - Ideja që është dëgjuar në Kosovë nga kryeministri Albin Kurti dhe është përsëritur edhe nga zyrtarë të tjerë, që të ndahet procesi i integritimeve evropiane nga dialogu me Serbinë, konsiderohet në parim e palogjikshme dhe e pamundur nga shumë diplomatë në selinë e Bashkimit Evropian. Kurti kishte thënë se është në interesin e shtetit të Kosovës, të BE-së dhe ShBA-së, që procesi i anëtarësimit të Kosovës në bllokun evropian të mos jetë i lidhur me dialogun Kosovë - Serbi për normalizim marrëdhëniesh. Këto deklarata Kurti i kishte bërë në konferencën “Plani i rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe integrimi më i shpejtë në BE”, që është mbajtur më 22 janar në Shkup të Maqedonisë Veriut. Disa prej diplomatëve të BE-së, me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë, thonë se zgjidhja e problemeve apo çështjeve të

hapura me fqinjët për secilin vend është në thelb të procesit të zgjerimit. “Bashkëpunimi rajonal, fqinjësia e mirë dhe gatishmëria për zgjidhjen e çështjeve të hapura me fqinjët nëpërmjet mjeteve politike dhe dialogut, qysh nga samiti i Zagrebit në vitin 2000 e deri me sot është vendosur si kusht në procesin e zgjerimit. Pa këtë kusht zgjerimi nuk do të kishte kuptim, sepse BE-ja nuk dëshiron të ketë vende anëtare të cilat kanë konflikte me fqinjët”, ka thënë një diplomat i BE-së duke rikujtuar se “normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një prej çështjeve më të rëndësishme jo vetëm për këto dy vende, por për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor”. Edhe zëdhënësi i BE-së për çështje të jashtme dhe të sigurisë, Peter Stano, ka thënë se raportet e mira fqinjësore dhe pajtimi janë gur themeltar i procesit të integritimit në BE.

“Raportet e mira fqinjësore, pajtimi dhe normalizimi i raporteve janë gur themeltar i procesit të anëtarësimit në BE për secilin vend aspirues. Kjo, po ashtu, është pjesë ligjore e përfshirë në dokumentet relevante që lidhen me procesin e anëtarësimit të Kosovës, Serbisë dhe të gjitha vendeve të tjera”, ka thënë në përgjigjen e tij Stano. “Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare kanë qenë të qarta si kristali - në deklaratat publike dhe direkt me partnerët, se rruga drejt BE-së për Kosovën dhe Serbinë çon përmes dialogut për normalizimin e raporteve”, ka thënë ai duke rikujtuar disa konkluzione të Këshillit të BE-së që nga viti 2013 e deri te konkluzionet e fundit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme nga 12 dhjetori i vitit të shkuar. Në ato konkluzione ishte shkruar se normalizimi i raporteve dhe implementimi i

obligimeve nga dialogu janë kushte esenciale në rrugën evropiane të Kosovës dhe të Serbisë dhe të dyja rrezikojnë t'i humbin rastet e rëndësishme në mungesë të progresit. Sipas diplomatëve evropianë, dialogu është mjet për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ndërsa normalizimi është kusht për të dyja vendet për progresin e tyre në procesin e integritimeve evropiane. Prandaj, thonë këto burime, është e pamundur dhe do të ishte në kundërshtim me logjikën e procesit të zgjerimit sikur ky kusht të hiqet. Burimet e BE-së kanë thënë se edhe nga Serbia është dëgjuar disa herë se nuk mund “të mbetet peng i dialogut”, sepse Beogradi pretendon se i ka përmbushur të gjitha obligimet, kurse Kosova nuk i ka përmbushur dhe, sipas tyre, “Kosova mban përgjegjësi për mungesën e progresit në

procesin e normalizimit të raporteve”. Por, ajo që është e kuptueshme, sipas diplomatëve të BE-së, është që secili vend që aspirojnë anëtarësimin në BE ta ketë rrugën e vet dhe të vlerësohet në bazë të meritave të veta individuale për përmbushjen e kriterëve. “Kjo do të thotë se nëse Kosova i përmbush obligimet e saj e Serbia jo, atëherë Kosova nuk do të pengohet për të përparuar. Do të vlejë edhe e kundërta, që Serbia të mos jetë peng i dështimit të Kosovës në përmbushjen e obligimeve”, ka thënë një diplomat i BE-së. Burimet në BE rikujtojnë se zbatimi i obligimeve nga dialogu do të bëhet edhe pjesë formale e procesit të negociatave të anëtarësimit me Serbinë, duke e përfshirë edhe në kapitullin 35 të kornizës negociuese të BE-së siç kanë kërkuar edhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian.



Vendimi për shkëmbimin e tokave, IKD-ja padit Kuvendin Komunal të Prishtinës

PRISHTINË, 25 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka njoftuar se ka paditur Kuvendin Komunal të Prishtinës duke kërkuar të anulohet vendimi për këmbimin e të paktën 10 hektarëve tokë në Badoc, në pjesën ku nuk lejohen ndërtimet, me 7 hektarë në Prishtinën e Re, zonën me më së shumti potencial financiar në kryeqytet e ku lejohen ndërtimet. Ky këmbim është bërë me

propozimin e ish-kryetarit të komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, më 2021, e me validimin e kryetarit aktual, Përparim Rama, më 2022. IKD-ja ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Në padinë e IKD-së është thënë se në vendimin që e ka marrë Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk janë aplikuar fare dispozitat ligjore, nuk

është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. “Me aktin përfundimtar administrativ, i nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkaluar kufijtë e autorizimit ligjor ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji”, është thënë në padinë e IKD-së.



Aktakuzë kundër pesë personave për shtytje në kryerjen e veprave terroriste

PRISHTINË, 25 JANAR - Prokuroria Speciale (PS) ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër pesë të pandehurve L. B., B. V., E. B., A. H. dhe A. S. Sipas aktakuzës, tre prej të

pandehurve nga periudha e panjohur kohore e në vazhdimësi në bashkëkryerje kanë shpërndarë dhe mundësuar përcjelljen e mesazheve të personat e tjerë duke nxitur kryerjen e akteve terroriste të sanksionuar nga

neni 134, lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndërsa të pandehurit L. B dhe B. V. kanë mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armët në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të sanksionuar nga

neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.



IKShPK-ja: Në Kosovë nuk ka raste të konfirmuara me fruth

**EPOKA
ERE**

FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka alarmuar lidhur me rritjen e rasteve të fruthit në rajonin e Evropës. Sipas OBSh-së, gjatë vitit 2023 janë shënuar 42 200 raste të fruthit në rajonin e Evropës, nga 941 sa ishin regjistruar më 2022. Fruthi është një ndër sëmundjet më ngjitëse dhe me vdekshmëri më të lartë të fëmijët nën 5 vjeç. Përkundrejt rritjes së madhe

të rasteve në Evropë dhe në rajon, në Kosovë nuk ka raste të konfirmuara me fruth. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) bën mbikëqyrjen e vazhdueshme të sëmundjeve ngjitëse, përfshirë këtu edhe fruthin, duke i ndërmarrë në vazhdimësi masat profillaktike dhe kundërepidemike. Sipas IKShPK-së, vaksinimi është mënyra më e mirë për parandalimin e përhapjes së fruthit. "Aktualisht Kosova ka shkallë të mirë të mbulueshmërisë me vaksinën

MMR (Fruth-Rubellë-Parotit). IKShPK është duke punuar intensivisht në koordinim me ekipet e vaksinimit dhe institucionet e kujdesit parësor shëndetësor që të identifikohen fëmijët të cilët nuk kanë marrë vaksinën MMR sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit. Me këtë rast, IKShPK u bënë thirrje prindërve dhe kujdestarëve ligjorë ta kontrollojnë kartelën e vaksinimit të fëmijëve dhe t'i vaksinojnë ata me kohë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Largohen billbordet ilegale me simbole dhe imazhe të diktatorëve e të agresorëve serbë në Zveçan

ZVEÇAN, 25 JANAR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se të enjten në Zveçan janë larguar billbordet ilegale me simbole dhe imazhe të diktatorëve e agresorëve serbë. "Sot në Zveçan janë larguar billbordet ilegale me simbole dhe imazhe të diktatorëve e

agresorëve të cilat janë të papranueshme në Republikën e Kosovës. Simboli i vetëm i Serbisë brenda shtetit tonë do të jetë ambasada e saj në Prishtinë. Republika e Kosovës është e përcaktuar qartë për vlerat demokratike dhe orientimin euro-atlantik të saj ndërkaq si institucione mbesim të

përkushtuar për rend e ligj dhe zbatim të kushtetushmërisë në çdo pjesë të vendit tonë", ka shkruar në "Facebook" Sveçla. Ai ka thënë se këto billborde dhe imazhe të fashistëve e të agresorëve si Vladimir Putin dhe kundërshtarëve të shtetit tonë nuk do të gjejnë vend në shtetin tonë.



Daut Haradinaj: Rruga Klinë - Gjakovë, në gjendje të mjerueshme



Gjakovë, 25 janar - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Daut Haradinaj, ka publikuar në "Facebook" një video të rrugës Klinë - Gjakovë, për të cilën thotë se është në gjendje të mjerueshme. Në këtë rrugë ka filluar të punohet para pesë vjetësh. "Rruga Klinë - Gjakovë e filluar para 5 vitesh vazhdon të jetë në gjendje të mjerueshme. Nuk kuptoj pse paguajnë taksa qytetarët e kësaj përderisa Qeveria e Kosovës i diskriminon kaq pamëshirshëm!", ka shkruar Haradinaj.

Latifi takon përfaqësues nga DEMOS-i dhe MAPL

RAHOVEC, 25 JANAR - I shoqëruar nga bashkëpunëtorët, kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka zhvilluar takim të rëndësishëm me përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe përfaqësues të projektit DEMOS. Në takim diskutuan

lidhur me performancën e komunës gjatë viteve 2018-2022 dhe grantin e fituar përgjatë viteve, procesin e rishikimit të SMPK-së dhe të GPK-së, projektet e financuara nga granti i performancës, si dhe çështje të tjera që ndërlidhen me Grantin e Performancës Komunale, i cili pritet të

shpallet më 9 shkurt 2024. Kryetari Latifi ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe para tyre ka paraqitur kërkesat e qarta sa iu përket çështjeve që i diskutuan. Komuna e Rahovecit mori lëvdata dhe përgëzime për angazhimin ekipor për punën në raportimin e saktë për performancë komunale.



Vështirë të mbahen zgjedhjet e parakohshme në vitin 2024



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Të gjithë për zgjedhje, askush nuk i do zgjedhjet: Qeveria Kurti 2 është qeveria që ka pasur më së shumti përkrahje të votuesve, që nga përfundimi i luftës sikur që nuk ka pasur fare kundërshtim opozitar. Opozita ka qenë e gatshme ta përkrahë qeverinë sidomos në bisedimet me Serbinë që është përcaktuese edhe për mbijetesën e Kosovës si shtet. Numri i madh i votave ua ka rritur nivelin e adrenalinitë LV-së dhe patericës S'GUXO duke ua dhënë sigurinë se mund të bëjnë ç'të duan dhe se askush nuk do t'i ndalë në rrugën e tyre të hakmarrjes dhe eliminimit të armiqve që në vendet e qytetëruara konsiderohen si kundërshtarë politik. Në takimin e parë KM i Kosovës ka kërkuar që asgjë që ishte bërë para tyre nuk vlejné dhe duhet të shpallen të pavlefshme. Pavarësia e Kosovës u shpallë me 21 shkurt 2021 kurse flamuri i Kosovapetrollit po në këtë datë u shpallë si flamur i Republikës së Kosovës, në komunikim e cilësonin si Republikë. Pa kaluar procesin e lustrimit të figurave publike u amnistuan duke u shndërruar në qytetarë të nderuar të Republikës të gjithë bashkëpunëtorët e Serbisë dhe Jugosllavisë, agjentë të UDB-së, hetues, prokurorë dhe gjykatës si edhe politikanë që e shkatërruan autonominë e Kosovës të viti 1974. U shpallën hajdutë, kriminelë, zhvatës dhe vrasës pjesa dërrmuese e komandantëve të UÇK-së të cilët u pushkatuan publikisht përmes medieve, tash të reformuara dhe demokratike. Nga Shoqata e të Burgosurve Politikë rekrutuan persona që, përveç kohës sa kanë qëndruar në burg për shkak të aktiviteteve, dikur kombëtare, nuk kanë bërë asgjë përveç se janë shquar si oportunistë të skajshëm duke u shndërruar në korba për t'ua nxjerrë sytë ish bashkëvuajtësve dhe bashkëluftëtarëve të tyre. E shitën prapancën për një grusht parash dhe për t'ua rehatuar anëtarët e familjes në poste që me asgjë nuk i meritojnë. SHBP, një organizatë shumë të fuqishme që kontribuoi drejtpërdrejtë për çlirimin dhe lirinë e Kosovës që, në rrethana normale do të ishte përcaktuese për të gjitha proceset politike në Kosovë e shndërruan në një kolos të tredhur. Veteranët e luftës u ndanë sipas zonave dhe forcës politike duke u përdorur çdo herë kur kishin nevojë shefat e tyre. Qeveria Kurti 2 kishte dha ka një përbërje që nuk i plotëson as kushtet minimale të profesionalizmit mirëpo, të gjithë ministrat dhe ministreshat janë në gjendje të “vdesin” për Kurtin për aq kohë sa e kanë prapancën në karrige. E kanë të qartë se me

Kurtin janë dikushi, pa Kurtin janë zero autoritet. Ministreshat i kanë bërë burrat e tyre me 4 vende pune, zotërues dhe ndarës të tenderëve, eliminues të armiqve të brendshëm dhe kërcënues ndaj atyre që marrin guxim që të mos pajtohen me ta. Rrugaçë! Merreni sot përbërjen e qeverisë Kurti 2 dhe aty nuk do ta gjeni asnjë pjesëmarrës të luftës së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në postin e ministrave keni dezertorë të ikur nga lufta pas një jave dhe të maskuar si refugjatë! Paturopësisht sot ata e kanë statusin e veteranit të luftës së UÇK-së. Apo, keni z/ministra, hajdutë ordinerë që, pasi kanë dezertuar nga lufta dhe janë zënë nga Policia serbe, me aq saktësi e kanë përshkruar lokacionin ku ka qenë, nga pozicioni ku kanë qëndruar e deri të “burgu” i UÇK-së. Madje, e kanë dhënë fjalëkalimin edhe të kompjuterit të babait. Këta sot ta udhëheqin Kosovën dhe presim të na mbrojnë nga Serbia!!! Ka ministra që kanë bërë miliona duke mbrojtur oligarkët në fushën e shëndetësisë sikur që e kaluara e tyre politike dhe kombëtare është 100 për qind bashkëpunimi me Serbinë! Ka ministra dhe ministresha që sikur shoku Zulo dhe shoqja Zylfije, karrierën e kanë bërë duke hëngër kredinë kombëtare, politike dhe vuajtjet e paraardhësve të tyre që ishin patriotë të bindur. KM i Kosovës ndaj opozitës ka pasur sjellje sadiste falë numrit të votave, vendimmarrjes absolute, urrejtjes patologjike që e ka ndaj krahut të luftës duke shkelur parimet se; i forti nuk tregon fuqi ndaj të pafuqishmit, i pasuri nuk e tregon mirëqenien para të varfrit, i pushtetshmi nuk tregon arrogancë ndaj të papushtetshmëve etj. Me fuqinë absolute vendimmarrëse dhe me mungesën gjithashtu absolute të të bërit opozitë, KM Kurti është dashur t'i thërrasë çdo mëngjes për kafe dhe konsultime partitë opozitare. Por, as që e ka bërë e as që do ta bëjë, shkak i egos patologjike dhe nuk do ta lëshojë rastin t'i hakmerret opozitës, sidomos krahut të luftës. Nuk vjen gjithmonë vera kah dera! LDK-në nuk e konsideron opozitë për faktin se me mercenaren presidente e ka ndarë në dysh, më lehtë e kontrollon dhe më lehtë e shantazhon. E ka si “xhokë” rezervë për marrëveshje të mëdha që Kosovën do e dërgojnë në theqafje në kohën kur Kosova thuaja është bërë vend i pajetueshëm ku të rinjtë të vetmen shpresë e shohin duke ikur në ndonjë vend tjetër. Albin Kurti rrugëtimin e nisi si idealist, përmes transicionit materialist karrierën do ta përfundojë si diktator. Në këto rrethana është gabim të priten zgjedhje të parakohshme sepse për to nuk është e gatshme as LV-ja e as partitë opozitare përkundër faktit që i bien të njëjtës daulle. Zeusi i LV-së, KM Kurti e vendosë nëse do të ketë zgjedhje dhe, po të ishte i sigurt se do ta përsërisë rezultatin e zgjedhjeve të fundit, vet do t'i provokonte zgjedhjet e parakohshme. E ka shumë të qartë se domosdoshmërisht do të

detyrohet të bëjë koalicion me njërin nga partitë e mëdha, me LDK-në ose me PDK-në, koalicioni me AAK-në nuk i kryen punë. Gjithashtu e ka të qartë se, nëse nuk luan 100 për qind sipas muzikës së atyre që vrasin dhe kthjellin, kurrë më nuk do të bëhet kryeministër, as në ëndërr. Në BE janë zgjedhjet, askush nuk merret më me Kosovën, Serbinë e kanë partner. Në SHBA, në zgjedhje sigurisht do të fitojë Donald Trump e që nuk i shkon në favor garniturës aktuale qeverisë. Po ta kishte rritur numrin e të punësuarve, ta kishte përmirësuar standardin e jetës, t'i kishte rritur rrogat, t'i kishte rritur pensionet dhe ndihmat sociale etj. KM Kurti do të kishte siguri brenda Kosovës edhe nëse perëndimi ia kishte shtrënguar fytyrën dhe zënë frymën. Me një situatë kur 50 për qind e buxhetit të shumicës së familjeve kosovare në muajt e dimrit shkon për faturat kriminale të rrymës KESCO e përkrahur nga organizata kriminale ZRrE, kur çmimet e artikuljeve të domosdoshëm ushqimorë janë më të shtrenjta se në çdo vend të BE-së, me një shëndetësi publike të udhëhequr nga një i dështuar që personalisht dhe familjarisht ka qenë në shërbim të oligarkëve dhe robëruesve të Kosovës dhe shqiptarëve, me një arsim që udhëhiqet nga një analfabete që as alfabetin e gjuhës shqipe nuk është në gjendje ta thotë nëse nuk i jepni disa muaj të mësojë atë, me një ministër të Penxhabit që rezervat shtetërore ia ka besuar një furrxhiu autodidakt, me një ministër për punë të jashtme që vërtet është krejt out sa i përket Kosovës. I vetmi sukses i saj është heqja e vizave për eskorta që do ta vizitojnë Dubain, ua ka lehtësuar kushtet e punës duke i bërë më të lëvizshme. Me një kontabilist të Wagnerit që i lufton veteranët e UÇK-së me shumë se vet Serbia etj. vështirë të ndërtohet një e ardhme për Kosovën, përkundrazi Kosova vetëm do të zbrazet. Pushtetarët aktualë edhe e duan zbrazjen e Kosovës sepse pakësohet mundësia e kundërshtimit sikur që më lehtë do të udhëheqin me ata që do të mbesin e që kryesisht do t'i shihni duke pritë radhën e pensionimit, para shtëpive të shëndetit, para dyerve të Halil Kastriotit, para kontejnerëve duke mbledhur kanaçe apo ushqim të mbetur, duke luajtur shah në sheshet e “Prishtinës Metropolitane” të shoqëruar nga “çunat e Përparimit”, qetë e shumë të regjistruar, por edhe të ardhur nga lagjet periferike në kërkim të një jete më të mirë dhe trajtimi më të mirë. Përafërsisht kjo do të jetë pasqyra e një të ardhme të afërt, disa sekuenca janë edhe sot të dukshme.

Bisedimet me Serbinë dhe siguria: Të mashtruarit dhe ata që vullnetarisht për shkak të posteve duan të mashtrohen nuk shohin asgjë të keqe gjatë sundimit trevjeçar të qeverisë Kurti 2. Situatën e përshkruajnë sikur të jetonim në Kaliforni, Norvegji, Butan, Dubai, Islandë, Finlandë e gjetiu. Disa edhe jetojnë në këto

vende. Kjo qeveri krenohet sidomos me rezultatet e bisedimeve me Serbinë dhe me integrimin e veriut të Kosovës, me protagonistë kryesorë KM Kurtin, Besnik Bislimin dhe Xheluan. Këtu pikërisht mendoj se janë dështimet më të mëdha të kësaj qeverie. Kur KM Kurti, si njeriun kryesor për bisedime me Serbinë e caktoi një person pa të kaluar kombëtare, politike, profesionale dhe morale tregon se është i dorëzuar mirëpo këtë person do ta shndërron në fund të tregimit në kurban shfajësimi për veten dhe adresë fajësimi për lëshimet kolosale. Besnik Bislimi as edhe një pordhë të vetme nuk guxon ta lëshojë pa lejen e Kurtit e lëre më të marrë vendime të rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës. Si shpërblim i ka njohur të drejtën ta punësojë kënd të dojë dhe ku të dojë, të ndajë rezerva shtetërore sipas parimit të njohur shqiptar, bukë e zemër, të përçajë shqiptarët e Luginës përmes projekteve korruptuese duke favorizuar marionetën që po e luan rolin e deputetit dhe duke penalizuar të gjithë të tjerët. Të dështuarit e Luginës i ka futur nëpër kabinete si këshilltarë dhe poste të tjera shpërblyese për mercenarizmin e tyre. Për tre vite nuk kishte asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Vizat u hoqën në saj të angazhimit të qeverive paraprahe në kohën kur qeveria aktuale kur ishte opozitë e pamundësoi liberalizimin e vizave për, së paku shtatë vite. I vetmi rezultat i prekshëm, i dukshëm dhe i pakundërshtueshëm i kësaj qeverie në planin ndërkombëtar është futja e sanksioneve nga BE dhe SHBA në muajin qershor të vitit 2023 e që duket që do ta shoqërojnë qeverinë deri në përfundim të mandatit. Nëse kjo qeveri do të kishte një kapacitet normal profesional, rasti i Banjskës do të ishte pikë kthese që do t'i hapte Kosovës të gjitha rrugët. Ndodhi e kundërta, edhe pas këtij rasti Serbia po konsiderohet faktor stabiliteti në krye me Aleksandar Vuçiqin kurse Kosova me KM Kurtin dhe Xhelal Sefqën po konsiderohen faktorë destabilizimi, prandaj edhe i kemi sanksionet të cilat nuk i ka Serbia. Nga ne vazhdimisht po kërkohen prova se po e bëjmë deeskalimin e situatës prandaj po na mbajnë ende nën sanksione, jo edhe Serbinë. Përpjekja për integrim të veriut është pasqyrë mashtruese, ka krijuar kushte për përshkallëzim edhe më të madh të situatës. Veriu është pa policë serbë, pa gjykatës serbë, pa prokurorë serbë, pa hetues serbë, pa administratë shtetërore të qytetarëve serbë të Kosovës në kohën kur 95 për qind të popullatës janë serbë që nënkupton se 2 për qind i vullnetit përfaqësues duan të imponojnë vullnetin 98 për qind të qytetarëve, kush beson dhe kush e pranon se keni qëllim të mirë. Nga këndvështrimi ynë është në rregull, është e drejtë, nga këndvështrimi i atyre që marrin vendime është e padrejtë dhe e papranueshme. Komedia e katër kryetarëve të zgjedhur në veri, tre shqiptarë dhe një boshnjak me një të kaluar

aspak të lavdishme politike e krijoi një situatë, sa qesharake aq edhe të turpshme, në emër të luftimit të Lista Serpskas dhe Radojçiqit (uroj që mercenarja politike Kulari të mos e lexoj këtë shkrim) e sollën një situatë që Lista Serbe do të rikthehet në pushtet, tash më e fortë dhe me legjitimitet të plotë. Praktikantë. Zajebnica nuk ishte e mirë prandaj Kurti i fitoi zgjedhjet me aq rezultat bindës duke deklaruar se nuk ka Zajebnicë dhe se nuk do të ketë. Nëse merret parasysh gropa që ka rënë Kurti me Marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit, Zajebnica e “Isa - Hashës, Esat Pashës ...” del të jetë kopsht me lule. Qarku po mbyllet dhe laku po shtrëngohet duke lejuar një frymëmarrje sa për ta realizuar Brukselin dhe Ohrin, jo për të mirë të Kosovës. Një grup tupellash të pushtetit duke llogaritur edhe Mexhlisin e Glokut po thonë se Brukseli dhe Ohri garanton njohje formale të Kosovës nga Serbia. Kështu e thotë edhe Tezja e LV-së, von Cramon që aspak nuk është e vërtetë. Zyra e presidencës shfaqë rezerva kozmetike por jo edhe përmbajtësore. Këtu përfundon Kosova si shtet i pavarur dhe sovran dhe fillon regionalizimi i Kosovës, me synim të qartë detyrimin e saj të krijojë një lidhje më të ngushtë me Serbinë pas 10 a më shumë vjetëve. Prandaj, në bisedime me Serbinë jemi ndarë shumë të humbur.

Zgjedhjet e mundshme: LV-ja mund të dalë fituese me rezultat 30-35 %. Rrugat e Re e Lumir Abdixhikut fillon nga Zyra e Vojsa Osmanit që e ndau LDK-në në dy pjesë dhe tash thirret në trashëgimin e Rugovës, pasi ia shkatërroi partinë, me destinim të përfundojë në Zyren e Albin Kurtit me një plan të qartë për një koalicion ku Lumlumi do të bëhet prime ministër, kurse Albin Kurti do të bëhej Vjosë Osmani - president. Vojsa Osmani është përcaktuar të luaj rolin kryesor në serialin për Barbie, edhe ashtu është deklaruar se është presidente Barbi. PDK-ja nëse përcaktohet për një opozitarizëm më agresiv dhe më këmbëngulës, plus me sforcimin e opozitarizmit kushtetues mund të presë rezultate më të mira. Nëse vazhdon me të njëjten mënyrë si deri sot, do të mbetet në moçalin elektoral të zgjedhjeve të fundit. PDK-ja duhet të bartë kompetencat te generatat më të reja që duhet të kenë rol vendimmarrës më të madh por të cilat nuk e mendojnë të kaluarën e partisë e dalë nga UÇK-ja, që kanë një linjë të qartë dhe të pastër kombëtare dhe që nuk bëjnë kompromis me çështje kombëtare, të UÇK-së apo me fatin e liderëve të tyre që po mbahen peng nga Gjykata Speciale Raciste. PDK-ja do të gabojë rëndë nëse hynë në koalicion parazgjedhor me ndonjë parti, publikisht apo heshtur. AAK-ja e kalon pragun zgjedhor pa asnjë problem. Krejt kjo nëse në ndërkohë nuk ndodhë ndonjë e papritur. E pritshme është të ketë probleme të mëdha brenda vet shqiptarëve në Kosovë.

LDK-ja ngre shqetësime për çmimin e papërbalueshëm në faturat e energjisë elektrike

PRISHTINË, 25 JANAR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nëpërmjet një konference për medie ka ngritur shqetësimet rreth çmimeve të papërbalueshme në faturat e energjisë elektrike.

Anëtar i Kryesisë së LDK-së, Visar Azemi, ka shpalosur dështimet e qeverisë në fushën e energjisë elektrike, përderisa dha alternativa dhe

zgjidhje të këtij problemi i cili po i rëndon qytetarët e Kosovës. “Teksa çmimi i rrymës u ngrit dy herë, dhe mafisë energjetike me njerëz të Kurtit si Martin Berishaj e Nagip Krasniqi iu rritën shifrat e të hyrave nëpër xhirollogaritë bankare, kjo qeveri për tre vjet s’i ka rritur as për një megavat kapacitetet e gjenerimit të energjisë elektrike. Në një

moment, Kosova e pati mundësinë ta ulë varësinë nga thëngjilli me projektin amerikan të gazit, por ministrja e Ekonomisë e refuzoi, duke u arsyetuar se projekti ka kosto të lartë dhe se me ato mjete mund të bëhen investime të tjera me risk më të ulët. Por, në mbi 900 ditë qeverisje asnjë investim nuk u bë në këtë fushë. Zero”, ka thënë Azemi.



Drejtori i ATK-së paraqet para anëtarëve të Odës Amerikane Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 JANAR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një tryezë diskutimi me drejtorin ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, me qëllim të diskutimit të dispozitave të reja të Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore.

Arian Zeka, drejtor ekzekutiv i Odës Amerikane, ka theksuar rëndësinë e këtij takimi si mundësi për fuqizimin e dialogut ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve kyçe si ATK-ja për të krijuar një ambient të favorshëm të të bërit biznes. Gjithashtu, presidenti i

sapozgjedhur i Bordit të Odës Amerikane, Blin Zeqiri, shprehi besimin e tij në partneritetin që Oda Amerikane promovon dhe ndikimin e saj te bizneset.

Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, gjatë takimit tregoi se institucioni që ai udhëheq përpiqet ta kultivojë frymën e bashkëpunimit me bizneset. Ai shpjegoi se për formalizimin e ekonomisë, mbështetje e madhe janë edhe vetë bizneset, duke shtuar se bizneset anëtare të Odës Amerikane, duke qenë në masë të madhe biznese të rregullta, mund të kontribuojnë në luftimin e ekonomisë joformale. Përveç ofrimit të një elaborimi për ligjin e miratuar së fundmi



për Administrimin e Procedurave Tatimore, Murtezaj tha edhe se qëllimi i ATK-së mbetet digjitalizimi i të gjitha

procese, përfshirë edhe procesin e rimbursimit. Ai tha se me qëllim të informimit më të mirë të sektorit privat për

ndryshimet e ligjit, ATK ka përgatitur një përmbledhje tabelare informuese.

Një tjetër temë e rëndësishme ishte edhe plani për ta krijuar faturën elektronike, ku Murtezaj tregoi se grupi punues veç është caktuar dhe rezultatet pritet të vijnë së shpejti. Pas përfundimit të këtij projekti, drejtori i ATK-së shpjegoi se për funksionalizimin e tij janë të nevojshme edhe ndryshime të reja në ligje.

Oda Amerikane e Kosovës falënderoi ATK-në për bashkëpunimin dhe gatishmërinë për të qenë pjesë e këtij takimi dhe për ta ndihmuar sektorin privat, duke shpresuar për më shumë bashkëpunime në të ardhmen.

Demokrasi Plus thotë se “Termokos”-i bëri disa shkelje në tenderin me vlerë 2.4 milionë euro



PRISHTINË, 25 JANAR - Ndërmarrja publike “Termokos” hapi tenderin për ndërtimin e objektit të ri administrativ në vlerë të parashikuar të kontratës 2.2 milionë euro, duke kërkuar nga operatorët ekonomikë të jenë të pajisur me certifikatën OHSAS 18001.

Demokrasi Plus (D+) ka theksuar se ky autoritet kontraktues refuzoi kërkesën e operatorëve ekonomikë për largimin e këtij kriteri, duke thënë se të gjitha kompanitë mund të pajisjen me këtë certifikatë. “OHSAS 18001

ishte një standard britanik për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, i cili ishte publikuar jashtë kornizës së Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (International Organization for Standardization). Kjo certifikatë ishte e vlefshme deri në vitin 2018, kur u zëvendësua plotësisht me ISO 45001:2018. Kompanitë e certifikuara sipas OHSAS 18001 kishin kohë deri me 31 mars 2021 të migronin në ISO 45001, datë pas së cilës këto certifikata nuk ishin më të vlefshme”, thuhet në

komunikatën e D+.

Më tej theksohet se, përveç vendosjes së këtij kriteri, i cili ishte i pamundur të plotësohej, “Termokos”-i shkurttoi afatin për dorëzimin e ofertave në 20 ditë. “Nga 99 operatorë që shkarkuan Dosjen e Tenderit, tre dorëzuan oferta, teksa vetëm një u vlerësua se kishte plotësuar kriteret, ofertues me të cilin ‘Termokos’-i lidhi kontratë për 2.4 milionë euro, apo 233,753.60 euro më shumë sesa që ishte vlera e parashikuar”, ka theksuar Demokrasi Plus.

Ministri i Bujqësisë së Bullgarisë vjen në Kosovë për vizitë dyditore

PRISHTINË, 25 JANAR - Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit i Bullgarisë, Kiril Vatev, ka mbërritur të enjten për një vizitë zyrtare në Kosovë. Në pikën kufitare në Han të Elezit është pritur nga ministri i BPZhR-së, Faton Peci.

Gjatë vizitës së tij dy ditore në Kosovë, ministri i Bullgarisë, Vatev, së bashku me ministrin Peci, në takimin bilateral që do

ta zhvillojnë gjatë ditës, do të diskutojnë për konkretizimin e bashkëpunimit në mes të dyja shteteve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes projekteve të përbashkëta zhvillimore.

Krahas kësaj, të dy së bashku do të realizojnë edhe një varg aktivitete, duke përfshirë këtu vizitat te disa agrobiznese vendore në vendin tonë, për

t’u njohur nga afër me potencialin zhvillimor të prodhuesve vendorë.

Ministri Peci dhe homologu i tij bullgar, Kiril Vatev, gjatë kësaj vizite do të bisedojnë edhe për mundësitë e thellimit të shkëmbimeve tregtare në mes shteteve të tyre në mënyrë që produktet e Kosovës të jenë pjesë e tryezave bullgare.



Mania e njerëzve për mumiet

Pushtimi i Egjiptit nga Napoleoni, për evropianët hapi portat e historisë së Egjiptit. Në atë kohë, mumieeve nuk iu jepej respekti që meritonin dhe, në fakt, mund të bliheshin nga shitësit ambulantë (siç tregohet në foton më poshtë) për t'u përdorur si ngjarje kryesore për festat dhe tubimet shoqërore që zhvilloheshin në shekullin e XVIII, shkruan Telegrafi. Elitat e kohës shpeshherë



Arkeologët marrin pjesë në çmbështjelljen e mumies Ta-Uza-Ra, priftëreshë e Amonit, në këtë pikturë vaji të fundit të shekullit XIX të artistit francez Paul Philippoteaux. Egjiptomania mbretëroi gjatë epokës viktoriane, duke i shndërruar festat e çmbështjelljes së mumieeve në një argëtim popullor

mbanin “Gostitë e çmbështjelljes së mumieeve” të cilat, siç sugjeron edhe emri, temë kryesore kishin mumien që do të hapej para një publiku të zhurmshëm, duke brohoritur dhe duartrokatur në të njëjtën kohë.

Sado e çuditshme të tingëllojë kjo, ishte kirurgu anglez Thomas Pettigrew ai që mund të cilësohet si pionier i kësaj forme të çuditshme argëtimi. Pettigrew ishte shkencëtar i shquar që kishte vaksinuar mbretëreshën Viktoria; ishte antikuar i njohur dhe autor i disa nga librave më mirë të kohës për mumiet dhe mjekësinë e lashtë. Por, gjithmonë do të mbahet mend si djaloshi që i bëri të njohura festat çmbështjelljes së mumieeve, paçka që këtë e bëri para një grupi mjekësh më 1821 (disi e justifikuar shkencërisht). Por, nga vitet 1830, ky veprim u shndërrua në festë.

Festat e çmbështjelljes përfunduan me fillimin e shekullit XX. Me zbulimin e rrezeve X u bë e mundur që historianët dhe shkencëtarët të shikonin më nga afër mumiet, pa i prekur mbështjelljet.

Dikur, mbetjet e ruajtura të egjiptianëve të lashtë bluheshin në pluhur dhe konsumoheshin si ilaç mjekësor. Në të vërtetë, mumia e bërë pluhur ishte kaq e popullarizuar saqë nxitë edhe një tregti të falsifikuar për të përmbushur kërkesën, në të cilën p. sh. mishi i lypsarëve të vdekur shitej si mish i egjiptianëve të lashtë të mumifikuar.

Me përparimin e Revolucionit Industrial, mumiet egjiptiane u shfrytëzuan për qëllime të tjera: një numër i madh mumiesh njerëzore dhe kafshësh u mbloodhën dhe u dërguan në Britani dhe Gjermani për t'u përdorur si plehra. Të tjerat u

përdorën për të krijuar pigmentet e së kafenjës së mumieeve ose u hoqën mbështjelljet e tyre e më pas u eksportuan në ShBA për t'u përdorur në industrinë e prodhimit të letrës. Autori Mark Twain madje raportoi se në Egjipt mumiet u dogjën si lëndë djegëse për lokomotivat. Me fillimin e shekullit XIX, mumiet u bënë objekte të çmuara ekspozimi dhe shumë

prej tyre u blenë nga koleksionistët e pasur privatë evropianë dhe amerikanë si suvenire turistike. Për ata që nuk mund të përballonin një mumie të tërë, mbetjet si një kokë, dorë ose këmbë mund të bliheshin në tregun e zi dhe të kontrabandoheshin në shtëpi.



Howard Carter hap varrin e faraonit Tutankhamen

Pas zbulimit të varrit të Tutankhamenit, lindi edhe mania që në gjithçka ia dha formën dizajnit art deco. Ndërkaq, vdekja e papritur në vitin 1923 e Lordit Carnarvon, sponsorit të ekspeditës së Tutankhamenit – nga shkaqet natyrore – shpejt iu atribuua besëtytnisë së re të “mallkimit të mumies”.

Por, pse njerëzit mendonin se mumiet ishin të mira për shëndetin? Fillimisht nxiteshin nga besimi se mbetjet njerëzore mund të kuronin çdo gjë – nga murtaja bubonike e deri të dhimbja e kokës e sulmi në zemër – dhe më pas nga idetë

makabre që njerëzit kishin për argëtimin pas darkës. Mumia ishte përshkruar për çdo gjë. Prandaj, papritur, njerëzit plaçkitnin varret egjiptiane jo vetëm për bizhuteri apo qeramikë, por edhe për trupat brenda.

Praktika e konsumimit të pjesëve të mumieeve të lashta egjiptiane – dhe më vonë kufomave të balsamosura të të gjitha llojeve – filloi në shekullin XI. Sipas historianit Karl Dannenfeldt, kjo ishte pasojë e keqkuptimeve dhe përkthimeve të gabuara. E quajtur sipas fjalës lokale për dyllë, “mum”, substanca u përdor në botën arabe si materie e shtrenjtë, e çmuar dhe efektive. Por, mumia ishte substancë e gjetur në një shpat të vetëm malor persian, ku kishte asfalt. Mirëpo, kur evropianët perëndimorë filluan të njiheshin me botën islame dhe të përkthenin tekstet e saj, një përkthim i vetëm i gabuar çoi në një konfuzion të gjerë rreth kuptimit të mumies. Sipas Dannenfeldt, një sërë përkthyesish të shekullit të XI dhe XII e identifikuan gabimisht mumien si substancë e nxjerrë nga trupat e ruajtur në varret egjiptiane. Një pjesë e konfuzionit erdhi nga ngjashmëria e fjalës mumie me fjalën mum dhe gjithashtu nga fakti se disa mumie të lashta egjiptiane u balsamosën duke përdorur asfaltin. Shkencëtarët tani e dinë se vetëm disa mumie janë bërë me këtë proces. Por, evropianët perëndimorë, të magjepsur nga gjetjet e lashta në



Një shitës egjiptian i mumieeve (foto e vitit 1875)

kishin praktikuar atë që tani njihet si kanibalizëm mjekësor, në përpjekjen për një shëndet më të mirë. Nga besimi se gjaku i gladiatorëve mund të shëronte epilepsinë e deri te përdorimi i yndyrës njerëzore në ilaçet shtëpiake, kanibalizmi mjekësor ishte i njohur në Evropën Perëndimore mesjetare. Por, me ardhjen e mumies, mjekët besuan se e gjetën një burim të ri të produkteve shëruese të bëra nga trupi i njeriut.

Mirëpo, jo të gjithë ishin të bindur për këtë. Guy de la Fontaine, mjek mbretëror, dyshoi se mumia ishte ilaç i dobishëm dhe ai ka parë mumie të falsifikuara të fshatarëve të vdekur në Aleksandri në vitin 1564. Kuptoi se njerëzit mund të mashtroheshin. Ata nuk konsumonin gjithmonë mumiet e vërteta të lashta. Kjo ndodhi meqë kërkesa e kaloi shpejt ofertën, duke çuar në një tregti të

shpejtë të mumieeve të rreme. Tregtarët filluan t'i shisnin kufomat e reja dhe trupat e kriminelëve të ekzekutuar, të njerëzve të skllavëruar dhe të tjerëve në përpjekjen për të përfituar nga kjo çmenduri. Rrëmbyesit e trupave “natën vidhnin trupat e atyre që ishin varur”, shkroi një vëzhgues, i cili vuri në dukje se trupat pastaj balsamoseshin me kripë dhe ilaçe, thaheshin në furrë dhe bluheshin në pluhur që farmacistët ia shtonin ilaçeve shtëpiake. Mirëpo, falsifikimet ilustrojnë një pikë të rëndësishme: kishte kërkesë të vazhdueshme për mish të vdekur për t'u përdorur në mjekësi dhe furnizimi i mumieeve të vërteta egjiptiane nuk mund ta përmbushte këtë kërkesë.


Kështu, farmacistët dhe herbalistët deri në shekullin XVIII shpërndanin ilaçe të bëra mumiet. Mbreti Charles II i Anglisë mori ilaçe të bëra nga kafka njerëzore, pasi pësoi një sulm në tru, dhe deri në vitin 1909 mjekët zakonisht përdornin kafkat për të trajtuar sëmundjet neurologjike. Për elitën mbretërore dhe shoqërore, ngrënia e mumieeve dukej ilaç i përshtatshëm mbretëror, pasi mjekët pretenduan se mumia ishte bërë nga faraonët dhe mbretërit hanë mbretërit.

Sot, tregu i zi i kontrabandës së antikitetit – përfshirë mumiet – vlen rreth tre miliardë dollarë. Asnjë arkeolog serioz nuk do të çmbështillte një mumie dhe asnjë mjek nuk do të sugjeronte të hante një të tillë. Por, joshja për mumiet mbetet e fortë. Ato janë ende në shitje, ende të shfrytëzuara dhe ende janë mall.

/Telegrafi/



Kavanoz i shekullit XVIII me kinse ilaç nga mbetjet e njerëzve të mumifikuar



Përfundon me sukses seminari me gjyqtarët e Superligës dhe Ligës së Parë



PRISHTINË, 25 JANAR - Nga data 19 deri më 25 janar është mbajtur seminari me gjyqtarët e Superligës dhe Ligës së Parë në Durrës. Ky seminar ka shërbyer që të vlerësohet forma fizike dhe teorike e gjyqtarëve para fillimit të stinorit pranveror. Gjatë seminarit gjyqtarët janë vizituar nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i cili në fjalimin e tij kërkoi nga gjyqtarët të jenë sa më vigjilentë gjatë ndeshjeve të stinorit pranveror dhe ta kryejnë detyrën e tyre me profesionalizëm. Punimet e këtij seminari i ka përcjellë edhe kryetari i

gjyqtarëve, Përparim Hasani, së bashku me Komisionin e Gjyqtarëve. Ai është ndarë i kënaqur me formën aktuale të gjyqtarëve si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë fizik. Seminari me gjyqtarë të Superligës është mbajtur nga data 19-22 janar 2024 nën përkrahjen e UEFA-së. ligjërues ka qenë instruktori i UEFA-së, Frank De Bleckere. Temat të cilat janë shtjelluar kanë qenë: “Konsistenca në marrjen e vendimeve”, “Loja me dorë”, “Menaxhimi i lojës” dhe “Bashkëpunimi si dhe diskutimi i klipeve nga ligat vendore dhe VAR

Linja e Intervenimit”. Seminari me gjyqtarë të Ligës së Parë është mbajtur nga data 22-25 janar 2024. Ligjërues kanë qenë Besfort Kasumi dhe Visar Kastrati, ndërsa temat të cilat janë shtjelluar kanë qenë të njëjtat të cilat janë diskutuar edhe me gjyqtarët e Superligës. Në ditën e fundit të seminarit gjyqtarët iu nënshtruan edhe testeve fizike dhe të gjithë i kanë kaluar me sukses. Në fund komisioni ka analizuar gjithë rezultatin dhe formën fizike të gjyqtarëve dhe ka konstatuar se gjyqtarët janë të gatshëm për fillimin e kampionatit.

Lirika Deva, rezultat pozitiv në Lojërat Olimpike për të Rinj



PRISHTINË, 25 JANAR - Lirika Deva ka pasur një tjetër paraqitje të mirë në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj “Gangwon 2024”. Ajo zuri vendin e 27 nga 79 garuese në disiplinën e sllallomit dhe la pas vetes 51 garuese, ku 34 dolën nga shtegu. Lirika mori edhe 118.95 pikë të FIS-it. Është ky rezultati më i

mirë ndonjëherë për Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj. Lirika pati kohën 1 minutë e 50.54 sekonda nga të dyja lëshimet. Në lëshimin e dytë ishte më e shpejtë për rreth dy sekonda. Deva garoi edhe të martën në sllallom të madh, ku u rendit e 31-ta. Në konkurrencën e meshkujve

është dashur të paraqitet edhe Klos Vokshi, por shkak i lëndimit të pësuar në garën e mbajtur të mërkurën në sllallom të madh, e kishte të pamundur garimin të enjten në sllallom. Me garën e së enjtes mbyllet edhe përfaqësimi i sportistëve tanë në LOD që po mbahen në Gangwon të Koresë së Jugut.

SHKURT

Shtyhet fillimi i stinorit pranveror në Superligën e hendbollit

Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës ka vendosur që stinori pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt) të shtyhet për një javë. Stinori pranveror ishte planifikuar të fillonte më 3 shkurt, por me kërkesë të klubeve, për shkak të telasheve me ngrohje në palestra, është shtyrë për një javë. Ndeshjet e para kampionale për këtë vit do të zhvillohen më 10 e 11 shkurt. Për shkak të aktiviteteve ndërkombëtare gjatë muajit shkurt, Superliga e femrave vazhdon më 9 mars.

Shevchenko zgjedhet në krye të Federatës së Futbollit të Ukrainës

Andriy Shevchenko është zgjedhur president i ri i Federatës Ukrainase të Futbollit. Ish-futbollisti i Dinamo Kievit, Milanit dhe Chelseat i fitoi 93 nga 94 votat e mundshme në kongres, njoftojnë mediet ukrainase. Pra, Sheva u votua me vendim unanim të delegatëve, ndërsa ai nuk e shfrytëzoi mundësinë e votës së 94-t për veten e tij. Legjenda ukrainase është golashënuesi më i mirë i Kombëtares së vendit të tij me 48 gola nga 111 ndeshje, ndërsa kishte luajtur për Ukrainën nga viti 1995 deri më 2012. Ai e kishte fituar Ligën e Kampionëve me Milanin në vitin 2003 dhe “Topin e Artë” në vitin pasues.

Muslija transferohet në Bundesligë

SC Freiburg ka nënshkruar me yllin e Kosovës, Florent Muslija. Muslija ka qenë në SC Paderborn që nga fillimi i vitit 2022 dhe ka luajtur 70 ndeshje konkurruese për klubin e divizionit të dytë gjatë kësaj periudhe. Ai shënoi 25 gola dhe 14 asistime. Në total, 25-vjeçari ka bërë 17 ndeshje në Bundesligë, 125 ndeshje në Bundesligën e dytë dhe 42 paraqitje në ligën e tretë. Muslija është trajnuar në radhët e të rinjve të Karlsruher SC dhe është lojtar aktiv i kombëtares së Kosovës, për të cilin ka luajtur 23 herë deri më tani. Florent Muslija u shpreh i lumtur me këtë transferim: “Kam mundur ta përjetoj atmosferën e mrekullueshme në stadiumin ‘Europa-Park’ në ndeshjen e Kupës në vjeshtë. Tani mezi pres t’i njoh shokët e mi të rinj, të zhvillohem më tej këtu dhe të jap gjithçka për klubin sportiv”.

Xavi: Me apo pa mua, Barça ka të ardhme të ndritur

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, pas humbjes 4-2 në çerekfinalen e Kupës së Mbretit ndaj Athletic Bilbaos, ka thënë se klubi ka një të ardhme të ndritur me ose pa atë në krye. Humbja në “San Mames” erdhi vetëm 10 ditë pasi Barça u mund 4-1 nga Real Madridi në finalen e Superkupës spanjolle, duke i lënë shpresat e tyre për trofe këtë sezon në La Liga dhe Ligën e Kampionëve. “Të gjithë trajnerët në klubet e mëdha varen nga trofetë, por ndihem krenar për mënyrën se si ne luftuam kundër një ekipi të madh deri në fund, veçanërisht të rinjtë”, ka thënë Xavi. “Ne po luajmë me të rinj. Skuadra është e re. Kjo është ajo që dua të them kur them se jemi në ndërtim. Mendoj se ky është fillimi i diçkaje të madhe. Pavarësisht nëse jam këtu apo jo, Barça ka një të ardhme të madhe. Ka një projekt vërtet të mirë, jo për mua si trajner, për sa i përket një brezi vërtet të mirë që vjen. Cubarsi, Fort, Lamine, Guiu dhe shumë lojtarë të tjerë... Fermin Lopez. Unë mendoj se është fillimi i diçkaje të madhe, por ne duhet të punojmë shumë dhe duhet të fitojmë. Ka të bëjë me fitoren te Barça”, ka shtuar Xavi.

Tifozët shqiptarë ‘pushtojnë’ faqen e UEFA-s, paralajmërojnë spektakël në Gjermani

TIRANË, 25 JANAR - Faqja zyrtare e UEFA “Euro 2024” në rrjetet sociale të mërkurën ka bërë një postim me fotot e disa tifozëve. Në këto foto qëndron edhe Besmir Limani, djaloshi me origjinë nga fshati Tatesh i

Strugës, i cili jeton në Zvicër. Duke parë që në këtë postim shfaqet flamuri “kuqezi”, shumë njerëz kanë komentuar dhe kanë bërë pëlqime në këtë postim, duke treguar përkrahje të madhe për Kombëtaren e

Shqipërisë. Kujtojmë që Shqipëria u kualifikua në “Euro 2024” pas një superaventure në ndeshjet parakualifikuese. Ekipi i Sylvinhos në Gjermani do të luajë kundër Spanjës, Kroacisë dhe Italisë.



‘Tërmet’ në UEFA, Boban jep dorëheqje

ZAGREB, 25 JANAR - Beteja për pushtet prek edhe një herë UEFA-n, me Çeferin, presidentin aktual që kërkon ta ndryshojë statutin, kjo për një arsye të qartë, kërkon të heqë kufizimin e mandatit të tij, pra të rikandidojë në përfundim të mandatit të tretë që i përfundon më 2027. Sipas kodit aktual, një president nuk mund të kandidojë më shumë se tre mandate, por Çeferin e sheh ndryshe. Ky vendim i numrit një të futbollit evropian ka sjellë pakënaqësi, ndërsa i fundit që reagon me një akt të fortë është Zvonimir Boban, drejtori teknik i UEFA-s, i cili ka dhënë dorëheqjen e tij duke lëshuar akuza të forta ndaj Çeferin: “Me trishtim dhe zemër të thyer nuk kam asnjë opsion tjetër përveçse të largohem nga UEFA”, theksoi legjenda kroate në një komunikatë të publikuar



nga “Bild”, duke insistuar se Çeferin nuk mendon për futbollin, por vetëm për ambiciet personale me vendimin që ka marrë për ta ndryshuar statutin në favor të rizgjedhjes përsëri në fund të këtij mandati, që duhej të ishte i fundit për të: “Edhe pse

kam shprehur shqetësimet e mia të thella dhe refuzimin tim të plotë të planit, presidenti i UEFA-s nuk sheh asnjë problem ligjor, aq më pak moral dhe etik. Ai dëshiron të vazhdojë me planin e tij në mënyrë që t'i ndjekë ambiciet e tij personale”.

Oklahoma merr kreun në Perëndim, fitojnë Milwaukee, Dallasi dhe Golden State



SAN ANTONIO, 25 JANAR - Milwaukee ngjitet në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 126-116 ndaj Clevelandit. Ndeshje e kontrolluar nga vendasit, ku u dallua Giannis Antetokounmpo, autor i një “triple double” (35 pikë, 18

rebounde, 10 asistime). Mirë u paraqit edhe Lillard me 28 pikë. Oklahoma ngjitet në krye të renditjes në Perëndim pas fitores me rezultat 140-114 në fushën e San Antonios. Alexander Shai vijon të jetë lider te skuadra e Thunderit, autor i 32 pikëve dhe 10

asistimeve. Rikthehet te fitorja Golden State, që mundi me shifrat 134-112 Atlantan. Cuminga e Curry me nga 25 pikë secili dhe Thompsoni me 24, bënë dallimin në fushë. Zhgënjeu Miami, që u mund me shifrat 105-96 në fushën e vet nga Memphis dhe zbret në vendin e gjashtë. Vince Williams ishte shënuesi më i mirë për miqtë. Fitore të rëndësishme korri Phoenixi, që falë 46 pikëve të Bookerit, mundi me shifrat 132-109 Dallasin jashtë fushe.

REZULTATET

Detroit - Charlotte	113-106
Washington - Minnesota	107-118
Miami - Memphis	96-105
Houston - Portland	131-137
Milwaukee - Cleveland	126-116
Dallas - Phoenix	109-132
San Antonio - Oklahoma	114-140
Golden State - Atlanta	134-112

SHKURT

Kumbulla mund të rikthehet te Verona

Hellas Verona është shumë aktive në merkaton e janarit. Mediet italiane raportojnë se klubi italian po mendon për rikthimin e mundshëm në formë huazimi të mbrojtësit të kombëtares shqiptare, Marash Kumbulla. Mbrojtësi i Romës ka qenë pjesë e “verdhebluve” deri në vitin 2020, kur u transferua te “verdhekuqtë”, pjesë e të cilëve është edhe aktualisht. Shqiptari pritet që në këtë merkato ta bëjë lëvizjen më të mirë për të, për të gjetur minuta në mënyrë që ta rifitojë gjendjen e tij më të mirë fizike, pas një pjese të parë të sezonit në të cilën ai nuk zbriti në fushë për shkak të operacionit në gju. Kumbulla ka edhe mundësi të tjera për të gjetur një vend titullari, pasi qendërmbrojtësi “kuqezi” pëlqehet shumë edhe nga dy klube të tjera të Serisë A, më saktë nga Genova dhe Torino.

Te Red Bulli nuk janë të qetë, ky do të jetë një vit ndryshe

Në Formula 1 askush nuk është plotësisht i sigurt se do të shpallet kampion edhe nëse vjen nga një sezon dominues. I këtij mendimi është James Allison, një nga drejtuesit e Mercedesit, që beson se as Red Bulli nuk mund të përballojë të pushojë një pushim të gjatë. “Imagjinoj që edhe te Red Bulli, pavarësisht një viti me paraqitje të shkëlqyera, nuk do të flenë të qetë, sepse askush nuk e di se çfarë do të bëjnë të tjerët. Mendoj se duhet të jesh i çmendur që të kesh besim, sepse di vetëm njërën anë të ekuacionit, pra atë që ke bërë”, ka thënë Allison. “Ka pasur vite kur makina del në pistë për herë të parë dhe shoferi menjëherë ju thotë se është një makinë e shkëlqyer. Edhe në këto raste nuk e besoni derisa të hyni në rrugën e duhur kundër makinave të tjera. Ky do të jetë një vit ndryshe për të gjithë”, u shpreh Allison.

De Rossi: Njerëzit në Arabinë Saudite janë të çmendur pas Romës

“Ne punojmë mirë. Kjo miqësore i ka prishur pak planet. Kemi humbur pak nga programi i punës, por kemi marrë njohuri për veten tonë. Kemi pasur një përvojë të re”. Këto ishin fjalët e Daniele De Rossit në televizionin “Roma” pas ndeshjes kundër Al-Shabab në Riyadh, të cilën “verdhekuqtë” e fituan me rezultatin 1-2. Më tej, trajneri i Romës foli edhe për ndryshimet dhe përparësitë që futbollit ka njohur së fundmi në Arabinë Saudite. “Është një vend, veçanërisht në nivel futbollit, në një evolucion të madh. Të gjithë jemi pak kuriozë të shohim se çfarë po ndodh dhe ndoshta më vonë do ta kemi mundësinë ta vizitojmë më me qetësi. Njerëzit këtu janë të sëmurë për futbollin e Romës. Shoh tifozë me tatuazhet e skuadrës. Është një surprizë shumë e këndshme. Ata po bëjnë investime të çmendura. Ndoshta pas disa vitesh do të kthehemi dhe do të gjejmë një strukturë edhe më të evoluar”, ka deklaruar De Rossi.

‘Bild’ zbulon të ardhmen e Mbappes, kontratë 5-vjeçare dhe 70 milionë euro në vit

Një version në lidhje me të ardhmen e sulmuesit francez Kylian Mbappe ka dhënë e përditshmja gjermane “Bild”. “Mbappe do të transferohet në Madrid në fund të këtij sezoni”, shkruan “Bild” duke zbuluar edhe

hollësi të tjera. Sipas së përditshmes gjermane, Mbappe dhe Real Madridi janë pajtuar për këtë transferim, e tash mbetet vetëm të përcaktohen hollësitë që kanë të bëjnë me pagën e tij. “Bild” shton se Mbappe do të

firmosë një kontratë 5-vjeçare nga e cila do të përfitojë 70 milionë euro kesh, plus 5 bonuse në vit. Gjithashtu, Reali do të paguajë menjëherë kesh 100 milionë euro të tjera në momentin që Mbappe do ta

hedhë firmën mbi kontratë, bonusi i mirënjohjes siç njihet në botën e futbollit. Pavarësisht prej përpjekjeve të mëdha dhe shumave marramendëse që i ka ofruar sheiku Al Khelaifi, Mbappe ka vendosur të ndryshojë

ambient. Me fanellën e PSG-së, Mbappe ka fituar 5 herë titullin në Francë, 2 Kupa Lige, 3 Kupa France, 4 Superkupa, por nuk mjaftojnë për Mbappe i cili kërkon me çdo kusht të fitojë Ligën e Kampionëve dhe “Topin e Artë”.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit 03/L-2012 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 7 dhe 8 paragrafi 1 pika b, si dhe paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022 dhe Vendimit nr.277 të datës 25.01.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK ”Trafiku Urban” SHA, Prishtinë, shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: Në afat të pacaktuar

Periodha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XXI

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

1.Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme, licencë për Sigurim Fizik
- Përvojë pune 1 vit
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
 - Dëshmi mbi shkollimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
 - Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.
- Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme: Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë punëtorët e rregullt të NPK “Trafiku Urban” SHA. Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

- Kandidati/ja, mund t’i dorëzoj këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban, përmes postës, dhe në formë të skanuar përmes email: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

Konkursi është i hapur nga data **26.01.2024** dhe përfundon më datë **09.02.2024** në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2024

1

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.278 të datës 25.01.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK ”Trafiku Urban” SHA, Prishtinë, shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Zyrtar për arka fiskale

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja: Në afat të pacaktuar

Periodha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: XIII

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën - Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Fakulteti Ekonomik
- 1 vit përvojë pune
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
 - Dëshmi mbi shkollimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës
 - Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
 - Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;
- Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim. Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit: Kandidati/ja, mund t’i dorëzoj këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban, përmes postës, dhe në formë të skanuar përmes email: punesimi@trafikurban-pr.com. Konkursi është i hapur nga data **26.01.2024** dhe përfundon më datë **09.02.2024** në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.01.2024

1

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U prilog članu 8. Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima, i Pravilnika br.01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta broj 1827 od 13.07.2022.godine kao i Rešenje br.277 od 25.01.2024. godine načelnik NPK-U33 Saobraćaj“ SH, Priština, saopštava:

J A V N I K O N K U R S

Radno mesto: radnik u osiguranju

Broj pozicija: 1 (jedan)

Trajanje: Na neodređeno vreme

Probni period: 3 meseca

Nivo plate: XXI.

Dužnosti i odgovornosti:

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: www.trafikurban-pr.com, u kartici - O nama, Izveštaji/Pravilnik

Stručna priprema:

- Srednjoškolska diploma, licenca za fizičko osiguranje
- 1 godina radnog iskustva
- Veoma dobro poznavanje rada na računaru;
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i biti sposoban da radi pod pritiskom.Potrebna dokumentacija.

Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
 - Dokaz o obrazovanju;
 - Kopija lične karte;
 - Dokaz o radnom iskustvu
 - Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci
 - Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost;
- Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

Prijava se može izvršiti u fizičkom obliku u zatvorenim kovertama u kancelariji br. 5 Gradskog saobraćaja, poštom ili putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, Konkurs je otvoren od 26.01.2024 i završava se 09.02.2024 do 16:00 časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 25.01.2024

2

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br. 278 od 25.01.2024. godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SHA Priština, objavljuje:

J A V N I K O N K U R S

Radno mesto: Fiskalni blagajnik

Broj pozicija: 1

Probni rok: 3 meseca

Trajanje: Na neodređeno vreme

Nivo plate: XIII

Dužnosti i odgovornosti:

O obavezama i odgovornostima posla možete se informisati putem veb-a: www.trafikurban-pr.com, u odeljku O nama, Izveštaji/Redovno.

Kvalifikacije i veštine:

- Ekonomski fakultet
- 1 godina radnog iskustva
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Nijedan disciplinski postupak nije u toku.

Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
 - Dokaz o obrazovanju;
 - Kopija lične karte;
 - Dokaz o radnom iskustvu
 - Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
 - Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost;
- Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Način primene:

Kandidat može dostaviti ove dokumente u fizičkom obliku kancelarijama za gradski saobraćaj, poštom, a u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;

Konkurs je otvoren od **26.01.2024** i završava se **09.02.2024** u **16:00** časova.

Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 25.01.2024

2

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr.1827 të datës 13.07.2022 si dhe Vendimit nr.279 të datës 25.01.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK “Trafiku Urban” SH.A, Prishtinë, shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Elektricitist i Objektit
